



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-0/OPK	Nr. Prot.	
Dep.		Br. Prot.	01-1853/15
Dep.		Prot No	
Nr. l faq.		Data	
Broj stranica	02	Datum	07-07-2015
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 18 (paragrafi 4, 8 dhe 12) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.07.2015 mori:

**V E N D I M**

- I. Ekziston konflikti i interesit në rastin me nr. AKK -03-02-3923/14, për z. Skender Zariqi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore të Prishtinës - Dega në Glogoc (Drenas) dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat.
- II. Agjencia do të kërkoj fillimin e Procedurës për Kundërvajtje nga Gjykata kompetente.
- III. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

**A r s y e t i m**

I. Bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, neni 18 (paragrafi 1 dhe 3), si dhe në bazë të vendimit Nr. 03-02-3923/15, është hapur rasti nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi për zyrtarin e lartë, z. Skender Zariqi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore të Prishtinës - Dega në Glogoc (Drenas) dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat "Avokat Skender Zariqi".

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (AKK-DPK-01-4025/14), pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë për të njoftuar për gjendjen në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtarit të lartë z. Zariqi, i është bërë e ditur se gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë nuk mund të ushtroj funksion menagjues në biznes privat, kjo për faktin se Ligji për

Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (Nr.04/L-051) e ndalon një gjë të tillë. Neni 15 (paragrafi 1) i këtij ligji shprehimisht thotë:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private”.*

Agjencia Kundër Korrupsionit i ka dërguar shkresë paralajmëruese zyrtarit të lartë (AKK-01-4964/14), me të cilën i është kërkuar që brenda afati ligjor të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të emëruar një person të besuar në biznesin privat, apo të mbyllë këtë biznes në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Përkundër Rekomandimit të Agjencisë z. Zariqi nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

**II.** Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e funksionit Publik (Nr.04/L-051) Neni 20, pika 1, çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuara në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3.

Sipas nenit 20 pika 2, “Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtari i lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit gjykata mund ti shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit”.

**III.** Sipas Nenit 18 paragrafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./ znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

